



PROCESVERBAL XII /2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së XII (dymbëdhjetë) për vitin 2022 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi:	KK Suharekë
Zyra:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Data:	20.12.2022
Ora :	13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Nënkryetarja e Komunës znj.Mihrije Suka

Të pranishëm tjerë:

z. Urim Suka

znj.Bulëza Kuçi

znj. Sanie Kuçi Rexhepaj

znj.Fidaije Kukaj

z.Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore

Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2023 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitet për vitin 2023;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2023;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2023 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitet për vitin 2023;

Kryesuesi - zyra e Kuvendit e ka përgatit planin e punës për vitin 2023 dhe në bashkëpunim me OSBE-në kemi parapa që ta mbajmë një punëtori së bashku ku kemi ftuar anëtarët e KPF-së dhe shefat e grupeve të partive politike. Në punëtorinë që është mbajtur ka dalë një rekomandim nga zyra e financave, ku është kërkuar që bartja e të hyrave vetanake të bëhet në muajin mars. Kryesuesi tutje elaboron planin e punës.

Avni Bytyqi - është një kërkesë prej drejtorisë së Arsimit që në muajin janar ta themelojmë komisionin për përzgjedhjen, interesimin dhe vlerësimin e kandidatëve që konkurojnë për pozitën e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkolla. Në bazë të udhëzimit administrativ kërkohet nga Kuvendi Komunal që të themelohet ai komision dhe të jetë për vitin akademik shkollor 2022-2023.

Dardan Berisha - lidhur me çështjen që ka kërkuar drejtoria e arsimit, në e kemi formuar një komision.

Pse duhet të formohet prapë?

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth pyetjes.

Liridon Fandaj - nëse shpallet konkursi në janar, a duhet të themelohet komisioni apo ekziston ky komision?

Avni Bytyqi – jo, ekziston ky komision.

Dardan Berisha - kur e kemi votu herën e fundit këtë komision keni thënë që nëse janë 5 konkurse, ky vendim vlen për këto 5 konkurse.

Avni Bytyqi - e saktë, ndërsa kur ta themelojmë tani, e përfundon vitin akademik komplet.

Urim Suka - nuk kam ndonjë vërejtje të theksuar te plani i punës. Dua të ndërlidhem me takimin që e keni pas dhe arsyeja pse kemi munguar në takim ka qenë për shkak të punës. Në çdo takim tjetër që Komuna organizon, nëse mund ta keni parasysh që takimet të fillojnë më vonë pasi punojmë në arsim.

Dardan Berisha - z. Salihu e dha arsyen e mungesës tuaj në atë takim dhe unë me Azizën dolëm keq si mësimdhënës edhe pse na takon me ligj me leshu mësimin, përndryshe pajtohemi me mendimin e Uritit që takimet me mbet në ora 13:00. Në takim kemi propozuar që brenda 6 muajve ose një viti me pas një

raport nga Drejtoria e Arsimit për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe problematikat dhe nëse është e mundshme, kjo pikë me hy. E di që raporti vjetor vje prej Kryetarit por shëndetësia dhe arsimit janë bazë.

Kryesuesi - sa i përket takimit që e cekim Urimi, nuk varet nga ne e gjitha sepse çdo herë kur ka bashkëpunime mes organizatave sikurse tash që e kemi pas me OSBE-në, ata e kanë planifikuar vendin dhe orën. Pasi që shumica e anëtarëve të KPF-së punojnë në arsim, ne e kemi lënë takimin në ora 13:00 kurse sa i përket seancave të Kuvendit mbetet në ora 10:00 sepse nuk janë rrethanat të mbahen më vonë.

Urim Suka - nuk është problemi te ne por fëmijët mbesin keq dhe është mirë me respektuar këtë. Sa i përket raportit të arsimit që tha Dardani dhe që e lidhi me drejtorinë e shëndetësisë, unë e kisha lidhë dhe drejtorinë e infrastrukturës dhe në kuadër të mandatit që ne kemi si Asamble, ne është mirë me planifikuar në plan që për çdo vit mu formu nga një komision monitorues ose verifikueses. Qëllimi është që ne kur po miratojmë diçka, me mbikqyrë që a po shkon ato mjete në vendin e duhur. Kjo ndoshta do ti nxiste të punonin më mirë këto institucione dhe unë mendoj që është mirë të formohen 3-4 komisione verifikuese.

Kryesuesi - ligjërisht organi më i lartë është Kuvendi dhe ligjërisht në çdo moment çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë me kërku raport.

Liridon Fandaj - ky po kërkon raport në atë që ne po e miratojmë te shërbimet publike. Rruga që është e planifikuar nuk po shtrohet por po shtrohet diçka tjetër dhe të paktën me na ardh një raport dhe ta dimë se se në cilën rrugë kanë shku.

Dardan Berisha - 42 fshatra është e vështirë një asamblist me i menaxhu.

Urim Suka - kur e bëjmë ne një komision prej të gjitha partive politike dhe vërtetojmë që jemi anashkalu si Kuvendi, atëherë pse po shkojmë ne në Kuvend. Përmes këtij mekanizmi që ne po dojmë me ndërtu, arrijmë me ndal ni t'keqe dhe me bo diçka ma të mirë për Komunën tonë.

Liridon Fandaj - ne mund ta bëjmë që një seancë të mbahet vetëm për raportime të drejtorëve.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor thotë që nëse Kryetari i Komunës nuk do me leju me raportu një drejtor, nuk mundet me raportu. Tutje jep sqarime.

Sanie Kuçi Rexhepaj - gjatë hartimit të këtij plani të punës, a e keni marrë një shqyrtim të planit paraprak se sa është zbatu? Më shqetëson njëra prej pikave, që është raportimi i PZHK-së për këtë vit, që realisht kam prit që këtë seancë ka me qenë raporti i zbatimit të planit të PZHK-së e që është obligim ligjor. Po pres që ka ndonjë përgjigje ose arsytim nga ana e Komunës. Këtë vit kemi pas inicimin e procedurave për planin rregullues të zones industriale në Biraq dhe po e shoh që prap është parapa në 2023-tën. Nuk po shoh ndonjë arsye se pse këtë vit nuk e ka sjell ekzekutivi për arsye se nuk ka pas pengesa ligjore. E kam pa një postim që diçka kanë fillu sa i përket planit rregullues të hollësishëm në Biraq dhe realisht nuk mundet me fillu asnjë procedure pa e dhënë miratimin ne si Kuvend.

Avni Bytyqi - plani i punës për 90 % është i referuar në baza ligjore. E kam thënë edhe në takim që e kemi pas për planin e punë që shqyrtimi i raportit të auditorit të brendshëm është e kundërligjshme të dërgohet në Kuvend sepse nuk është publik për të gjithë. Ajo që e tha Sanija është fakt që Drejtoria ka për obligim me raportu për çështjen e PZHK-së se sa është zbatu dhe pikërisht është fut dhe Harta Zonale sepse në dhjetor i bën një vit dhe në çoftëse nuk bëhet ky raport është e vështirë me fillu procedurat e revidimit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - unë mendoj që raportet duhet me u bë shumica në janar, që me përfundu viti dhe me raportu në janar, dhe shpresoj që arsyetja me qenë kjo. Nëse mbas tetë viteve dojm me fillu planin e ri zhvillimor të Komunës, ne nuk kemi shanca me fillu pa e pas vlerësimin paraprak të PZHK-së.

Urim Suka - e kemi diskutu më herët dhe kemi kërku që drejtorat me qenë prezent në takim.

Kryesuesi - në puntori ju kemi ftuar shefat e partive politike dhe anëtarë e KPF-së dhe jo rastësisht edhe drejtorat e drejtorive. Kryesuesi e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2023;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - vërejta një gabim në material që ndoshta është gabim teknik te pjesa e fundit e dhjetorit ku thotë:Përgatitja e planit të veprimit për KKSB për vitin 2023 dhe duhet të jetë 2024,por përtej kësaj ne sigurinë duhet ta trajtojmë pak më seriozisht.Ky komision vetëm një herë e ka pru një raport.

Avni Bytyqi - me datën 14 kemi pas takimin e fundit për vitin 2022 dhe të pranishëm kanë qenë përfaqësues të OSBE-së dhe LMT-së. Sipas tyre KKSB në Suharekë është njëra ndër KKSB-të ma funksionale dhe produktive në regjion. Ne nxjerrim rekomandim nga KKSB-ja dhe i adresojmë te arterët kryesor se kush ka me ekzekutu dhe zbatu.

Dardan Berisha - nuk po e shoh asnjë masë dhe as një plan për trajtimin e qenve endacak sepse ne e kemi nda një buxhet të veçantë.Te analiza e vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës,në prill e keni analizu dhe unë mendoj që ky problem është çdo muaj.Trajtimi i mbrojtjeve të pyjeve nga dëmtuesit ilegal është temë që duhet të diskutohet çdo takim.

Urim Suka - pajtohem me mendimin e Dardanit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi: 14:00

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj